



Datë: 20.08.2025
Numër Protokolli: 6067/2025

A.nr.1163/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, më Kaltrina Prenaj-si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1163/2025, të datës 19.06.2025, të parashtruar nga ankuesi S.A, kundër organit të punësimit: Agjencia e Punësimit, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 20.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.1163/2025, e datës 19.06.2025, e parashtruar nga ankuesit, S.A.

A r s y e t i m

Ankuesi, S.A (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 19.06.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN00016968, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Zyrës së Punësimit*”, në Zyrën e punësimit në Deçan, të shpallur nga Agjencia e Punësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 01.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Punësimit, ndërsa, kjo fundit, me datë 07.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 19.06.2025, **është e pasafatshme**, sepse:

Nga administrimi i provave materiale të çështjes rrjedhë se organi publik – Agjencia e Punësimit më datë 07.03.2025, ka shpallur Konkurs publik me numër reference RN00016968, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Zyrës së Punësimit*”, klasë të pozitës Drejtues i Ulët, një (1) vend i lirë pune, me mandat 4 vjeçar, në Zyrën e Punësimit në Deçan, i hapur për aplikim 08.03.2025 deri më 06.04.2025.

Rrjedhimisht, në këtë konkurs kanë aplikuar 13 kandidatë, përfshirë këtu edhe ankuesin, i cili së bashku me 6 kandidatë tjerë ka janë përfshirë në fazën e verifikimit paraprak, duke u konsideruar si kandidatë që kanë plotësuar kushtet e konkursit, ndërsa i njëjti i është nënshtruar edhe fazave të vlerësimit profesional, ashtu që në testin me shkrim ka arrit 41.6, si pikë të mjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit, më datë 19.05.2025, ka publikuar Njoftimin me numër protokolli Nr.1615, nga i cili njoftim rezulton se procedura e pranimit sipas konkursit me numër reference RN00016968, ka përfunduar pa kandidatë fitues me arsyetimin se asnjëri nga kandidatët nuk ka kaluar testin me shkrim.

Ankuesi, pas publikimit të Njoftimit me numër protokolli Nr.1615, të datës 19.05.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se përmbajtja e testit me shkrim ka qenë jashtë përshkrimit të detyrave të punës, shton se rreth 50% e pyetjeve të testit me shkrim ishin jashtë fushës së përshkruar me konkurs, gjithashtu përbërja e Komisionit të vlerësimit ka qenë e paligjshme, pasi që përbërja e komisionit të rekrutimit duhet të bëhet përmes platformës elektronike të menaxhimit të burimeve njerëzore. Kërkon nga Këshilli të shqyrtoj ligjshmërinë e testit me shkrim, të verifikoj parregullsinë të Komisionit të Pranimit si dhe ta anuloj konkursin e shpallur dhe ta bëj përsëritjen e testit, duke garantuar transparencë dhe drejtësi në test.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publike të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 ku përcaktohet se: *12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative*, nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 paragrafit 1, ku përcaktohet se: *1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*, ndërlihur me nenin 127 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*, si rrjedhojë dhe duke u bazuar në kuadrin përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës Kolegji konstatoi, se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit, më datë 19.05.2025 ka publikuar Njoftimin me numër protokolli Nr.1615, si njoftim përfundimtar, nga i cili njoftim ka rezultuar se procedura e pranimit me numër reference RN00016968, për pozitën e punës *“Udhëheqës i Zyrës së Punësimit”*, në Zyrën e punësimit në Deçan, ka përfunduar pa kandidatë fitues, ndërsa, ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka parashtruar më datë 19.06.2025, që është jashtë afatit të përcaktuar me dispozitat e cekura si më lartë, pra ankesa është parashtruar në ditën 31-të pas Njoftimit përfundimtar, si rezultat i kësaj, ankesa e parashtruar nga ankuesi është jashtë afatit të përcaktuar me dispozitat e Nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që mbi këtë bazë ankesa e ankuesit me numër A.nr.1163/2025 është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1163/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, S.A;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.